



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Mekanizmi Kombëtarë për Parandalimin e Torturës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201400237/2

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave për normalizimin e situatës së krijuar në IEVP Peqin, sipas problematikave të evidentuara në këtë rekomandim.*

**Drejtuar : Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve
Z. Artur Zoto**

TIRANË

**Drejtorit të IEVPenale, Peqin,
Z. Armand Shqarri**

Peqin

Të nderuar Zotërinj,

Avokati i Popullit pasi u njoh nga media vizive lidhur me ankesat dhe refuzimin e ushqimit të disa të paraburgosurve në IEVP Peqin, me datë 11.02.2014, në përmbushje të kompetencave kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit edhe në rolin e Mekanizmit Kombëtarë për Parandalimin e Torturës, dërgoi menjëherë në vend një grup pune për hetimin administrativ të këtij rasti.

Në përputhje me zhvillimin e procedurave hetimore, grupi i punës fillimisht kreu një takim me Drejtorin e institucionit dhe i komunikoi atij qëllimin e vizitës.

Në vijim, ekspertët e Avokatit të Popullit kanë marrë takim më vete në dhomat e takimit me familjarët me të 59 të paraburgosurit e akomoduar në ato ambiente mbas transferimit të tyre nga IEVP Rrogozhinë me dt 31.01.2014.

Gjatë intervistave, nga ana e të paraburgosurve janë parashtruar një sërë problematikash, të cilat së bashku me analizën ligjore referuar legjislacionit në fuqi, do të renditen më poshtë:

Me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, IEVP Peqin është kategorizuar burg i sigurisë së lartë, me një seksion të sigurisë së zakonshme dhe një seksion paraburgimi. Kapacitetet akomoduese të institucionit janë për **685** persona, të ndarë 408 të dënuar për sigurinë e zakonshme, 229 të dënuar të sigurisë së lartë dhe 48 të paraburgosur. Në momentin e vizitës në IEVP Peqin gjindeshin gjithsej **867** të dënuar dhe të paraburgosur.

Shënime paraprake

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të vizitës, grupi monitorues zhvilloi fillimisht takimin me Drejtuesin e Institucionit ku shpjegoi qëllimin e kësaj vizite, si dhe kërkoi shpjegime lidhur me situatën e institucionit dhe trajtimin e të paraburgosurve të transferuar nga IEVP Rrogozhinë në IEVP Peqin në natën e datës 31.01.2014. Nga përfaqësuesit e institucionit u informuam se 59 nga këto të paraburgosur vazhdonin të qëndronin të akomoduar në kushte emergjence në ambjentet e improvizuara të takimit të dënuarve me familjarët në IEVP Peqin. Gjithashtu u informuam se transferimi i tyre në IEVP Rrogozhinë do realizohej së shpejti në varësi të përfundimit të riparimeve të godinës së demtuar nga zjarri në IEVP Rrogozhinë.

Trajtimi

Gjatë kësaj vizite monitoruese, në kontaktet personale dhe në privatësi që ekspertët e grupit të monitorimit patën me të paraburgosurit e ndodhur në ambjentet e përshtatura të takimeve të të dënuarve me familjarët u parashtruan shumë ankesa nga ana e tyre. Në një dhomë 4x5m akomodoheshin 12 persona të cilët flinin në dyshekë në tokë. Në këto dhoma nuk kishte asnjë orëndi apo paisje që të krijonte kushte minimale jetese. Mungesa e hapsirës jetike dhe mbipopullimi në këto dhoma kishte krijuar një ndjenjë të trajtimit degradues tek të të paraburgosurit të cilët ishin në gjëndje të rënduar psikologjike. Sipas bisedave me të paraburgosurit rezultonte se dhe shërbimet si ajrimi, larja në dushe, telefonatat dhe shërbimi shëndetësorë ishin ofruar në minimumin e mundshëm për shkak të ambjenteve të papërshtatshëm dhe mbipopullimit të këtyre ambjenteve.

Konkluzione

-Grupi i monitorimit konstatoi kushtet degraduese materiale dhe mungesën e shërbimeve esenciale ndaj 59 të paraburgosurve të akomoduar në ambjentet e takimeve të të dënuarve me familjarët në IEVP Peqin.

-Kjo gjëndje ka ardhur si rezultat i pamundësisë për akomodimin e tyre në regjime si rezultat i mbipopullimit të tejskajshëm të sektorëve të burgut Peqin. Kjo situatë ka krijuar gjëndje pakënaqësie dhe tensioni në ambjentet e akomodimit të përkohshëm duke sjellë dhe reagime për refuzim ushqimi dhe ankesa në grup të të paraburgosurve të vendosur në këto ambjente.

-Nisur nga vlerësimi real i gjendjes në ambjentet e akomodimit emergjent të 59 të parburgosurve, të transferuar nga IEVP Rrogozhinë në IEVP Peqin, me dt 31.02.2014, konstatojme se në rast se transferimi i tyre apo akomodimi i tyre në kushte të parashikuara ne ligj nuk realizohet brenda afatit të premtuar dt. 15,16.02.2014 dhe ato vazhdojnë të mbahen në të njëjtat kushte, ekziston rreziku për trazira dhe aksidente në atë sektor.

-Vleresojmë se marrja masave për transferim ka karakter emergjent dhe te domosdoshem, pasi edhe nga aktet nderkombetare dhe legjislacioni ne fuqi, trajtimi i tyre ne këto kushte mbipopullimi dhe mungese hapësire jetike dhe mungese shërbimesh konsiderohet nje shkelje flagrante e të drejtave të njeriut.

Për këtë qëllim dhe në ndihmë të parandalimit të situatave të tilla që mund të përbëjnë trajtim degradues, Avokati i Popullit në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*, në bazë të Nenit 74/1 pika b te Ligjit Nr. 9888 dt. 10.03.2008 *“Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin Nr. 8328 dt. 16.04.1998 Per te drejtat dhe trajtimin e te denurave me burgim”* ku parashikohet midis te tjerash se: *“Avokati i Popullit nepermjet Mekanizmit Kombetar per Parandalimin e Tortures ka keto kompetenca b) paraqet rekomandime per organet perkatese, me qellim qe te permiresohet trajtimi dhe kushtet e individeve qe u eshte hequr liria dhe te parandalohet tortura dhe trajtimi ose denimi i eger, çnjerezor dhe poshterues”*, si dhe ne baze te nenit 21/c të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* (me ndryshimet përkatëse) ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkelje të drejtave dhe lirive”*

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave të menjëhershme për transferimin e të 59 të parburgosurve të akomoduar ne ambjentet e takimit të denuarve me familjarët në IEVP Peqin brenda datës së premtuar 15,16.02.2014
2. Marrjen e masave për akomodimin e të parburgosurve në dhoma në sektore të parburgimit dhe trajtimin e tyre sipas standardeve ligjore.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI